

VENDIM
Nr. 108, datë 21.4.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1100/1 prot., datë 17.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV blue 1’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1100 prot., datë 8.4.2026, shoqëria “SPV Blue 1” ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw”, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 50 mw.

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 184, datë 25.3.2021, dhe Kontratës nr. 2720 rep., nr. 2066 kol., datë 9.7.2021, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik “Blue 1” dhe veprave ndihmëse të tij.

2. Përputhshmëria e aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të Rregullores, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës, sipas germave “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, germa “a”, të Rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE shtojcën 1 të plotësuar. Po ashtu, në kuadër të informacionit shtesë, vlerësohet t’i kërkohet asaj të informojë mbi mënyrën e financimit të këtij investimi.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë, sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., me qëllim marrjen dijeni mbi këtë procedurë, në kushtet kur modifikimi i kërkuar lidhet me integrimin e njërive të depozitimit të energjisë si vepra ndihmëse të centralit, çështje që lidhen me aktet e

miratuara prej tyre, përputhshmërinë mjedisore dhe aspektet teknike të operimit të sistemit elektroenergjetik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 50 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti